

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin***Prill, 2021**

U mbajtën një varg takimesh SBASHK- MASHTI Në përpjekje për bashkëpunim dhe angazhime të përbashkëta



Pas takimit të parë që përfaqësuesit e SBASHK-ut kishin zhvilluar në ambientet e MASHTI-t, e që kishte për qëllim që fillimisht të përgëzohet Ministra Nagavci për detyrën dhe të shprehet gatishmëria për bashkëpunim në shërbim të arsimit dhe për zgjidhjen e gjithë çështjeve të ngritura, kanë vazhduar takimet e komunikimi i rregullt. Pas kësaj ka ndodhur vizita e Ministres Nagavci me anëtarë të kabinetit të saj në selinë e SBASHK-ut duke shprehur kështu gatishmërinë për bashkëpunim dhe ...(faqe 4)

Një aktivitet i veçantë i SBASHK-ut


U përgatiten trajnerë për trajnimin e ri të licencuar



SBASHK ka kohë që falë angazhimet e përkushtimit
...(faqe 5)

SBASHK ka rinisur me
organizmin e trajnimeve për
anëtarësinë

U rinis me 8 grupe për të
vazhduar edhe me dhjetëra
grupe të tjera



Duke respektuar ...(faqe 7)

Intervistë me mësimdhënësen dhe trajneren Blerina Haraqija

**Mësimdhënia profesion dhe
mision i shenjtë**



Blerina Haraqija është
mësimdhënëse e dalluar
...(faqe 3)

SBASHK u takua me ministrin Vllas

U përsërit kërkesa që punëtorët e arsimit të jenë prioritet në vaksinim



Jo për të qenë të privilegjuar, por për të krijuar
parakushtet ...(faqe 6)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Nuk është mirë që idetë aq lehtë të kthehen në vendime



Pandemia ka pllakosur botën dhe ka krijuar vështirësi e sfida që nuk ka mundur askush t'i imagjinojë. Një mijë e një telashe u krijuan në ekonomi, në turizëm, në shëndetësi, arsim e në gjithë sektorët në tërësi. Edhe shteteve shumë të zhvilluara ekonomikisht Covid u solli probleme e kokëçarje e mos të flasim për problemet që u krijuan në shtetet më pak të zhvilluara ekonomikisht e të mos flasim fare për shtetet e varfra. E tërë kjo situatë plot strese u reflektua edhe në sistemin

arsimor dhe në Kosovë e kudo në botë janë duke u bërë angazhime maksimale të personelit arsimor që në rrethanat e reja të ketë rrjedhë sa më të mbarë procesi mësimor.

Në këtë situatë duhet menduar dhe vepruar arsyeshëm dhe duhet bërë gjithë angazhimi që të unifikohen përpjekjet me qëllim që ta përfundojmë këtë vit shkollor duke zhvilluar procesin mësimor në institucione. Idetë që kanë individët nuk është mirë të kthehen në vendime. Një e tillë është edhe ajo për mësimin plotësues që doli nga MASHTI. Ta kryejmë këtë vit shkollor dhe të mposhtet pandemia , që po kërcënon shëndetin dhe jetën e njerëzve e pastaj ulemi bashkë dhe debatojmë e vendosim edhe për ide të reja dhe i vëmë në jetë nëse pajtohemi të gjithë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me mësimdhënësen dhe trajneren Blerina Haraqija
Mësimdhënia profesion dhe mision i shenjtë



Blerina Haraqija është mësimdhënëse e dalluar në shkollën “Mustafa Bakia” në Gjakovë. Është e angazhuar edhe në ekipe punuese në kuadër të shkollës dhe jashtë saj me qëllim të përmbushjeve të objektivave të

caktuara që i kërkon sistemi arsimor. Ka dhënë kontribut të lartë edhe në përgatitjen e gjithë materialit për një trajnim, që është licencuar, e që i dedikohet mësuesve. Ajo mësimdhënien e vlerëson me arsye si profesion, por edhe si mision të shenjtë.

Arsimimi sot:

Kush është Blerina Haraqija ?

Blerina

Jam Blerina Haraqija, e lindur me 31.7.1980 në Gjakovë. Kam përfunduar studimet për edukimin fillor dhe master në drejtimin “Mësimdhënie dhe kurrikulë”.

Si mësimdhënëse kam filluar në shkollën fillore të mesme të ultë “Selman Riza” në para-lagjen e qytetit nga viti 2005 deri në vitin 2012. Nga viti 2012 vazhdoj të punoj në shkollën fillore “Mustafa Bakija” në Gjakovë. Gjatë kësaj periudhe fillimisht përveç mësimdhënies kam pasuruar bagazhin tim profesional duke u përpjekur që kjo të më shërbejë për tu angazhuar edhe në organizata dhe programe tjera e cila ka begatuar edhe më shumë artin e mësimdhënies në aspektin profesional e poashtu edhe në rrafshin personal e cila ka ndikuar në motivimin dhe përkushtimin edhe më të madh. Jam e angazhuar edhe në ekipe punuese në kuadër të shkollës dhe jashtë saj me qëllim të përpushjeve të angazhimeve të caktuara që i kërkon sistemi arsimor.

Arsimimi sot:

Si e vlerësoni profesionin e mësimdhënies?

Blerina:

Profesion dhe mision i shenjtë. Mësimdhënia është art në vete. Ajo fillimisht përfaqëson karakterin dhe individualitetin tënd. Kur kësaj i shtohen niveli i shkollimit, ngritjet akademike, angazhimi i pakursyer në ngritjen e cilësisë në arsimin dhe punën së drejtpërdrejtë me nxënës duke përdorë praktika të ndryshme cilësore dhe kreative, ky mozaik plotësohet në mënyrë perfekte. Profesionin e mësimdhënies është mjaft kompleks i cili në vete ngërthen fusha të natyrave të ndryshme si përgatitje të planit të përgjithshëm global deri te ai individual, vet procesin e mësimit që duhet të jemi koshient dhe shumë të kujdesshëm karshi gjithë nxënësve në gjithpërfshirje, ana shpirtërore dhe emocionale, respektimi i të drejtave të fëmijëve dhe vlerësimi si procesi më i ndjeshëm, kreativiteti etj

Duke e parë këtë gamë të gjerë të veprimtarive që realizon një mësimdhënëse padyshim duhet të vlerësohet lartë nga të gjithë kjo punë e bazuar në profesionalizëm dhe vullnet.

Arsimimi sot:

Cila është vlera e trajnimeve që ofron SBASHK-u?

Blerina

Padyshim që çdo iniciativë me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve, si në rrafshin individual ashtu edhe profesional në përgjithësi, përmes programeve të shumta që ofron SBASHKU padyshim që nuk mbetet vakum joprofesional për asnjë mësimdhënëse, gjithmonë duke e përfshirë edhe ekipin e madh të të angazhuarve. SBASHK-u ofron programe të akredituara nga MASHT gjë e cila i plotëson profesionalisht në shumë fusha të gjithë mësimdhënësit. Mjafton të kenë vullnet që ti përqafojnë këto programe të akredituara që të rritet potenciali arsimor në resurset njerëzore në shkollat tona, ku qëllimi i vetëm është ngritja e cilësisë së mësimdhënies e cila ndikon drejtpërdrejtë në cilësi më të lartë të të nxënës.

Arsimimi sot:

Si ndiheni në cilësinë e trajneres?

Blerina

Fillimisht si trajnere kam qenë në programe e organizata të tjera ndërsa së fundmi jam angazhuar edhe në SBASHK në dy prej atyre programeve të akredituara nga MASHT-i. Puna në rolin e trajneres kërkon shumë punë dhe angazhim me përgjegjësi të lartë por mbi të gjitha është ndjenjë e veçantë që ke mundësi të bartësh te kolegët njohuri dhe përvoja të reja të ngritjes profesionale. E bukura është që gjatë trajnimeve ke mundësi të takosh profesionist të fushave tjera ku gjithsecili paraqet përvojën nga këndvështrimi i tyre dhe si të tillë të absorboj për ti shërbyer zhvillimit tim adekuat. Pra është marrëdhënie reciproke profesionale. Dija është relative dhe si të tillë e pranoj.

Arsimimi sot:

Me cilat çështje duhet të merret SBASHK?

Blerina:

Organizata jone është mjaft e përkushtuar në qëllimin

e vet dhe si të tillë kanë vepruar dhe po veprojnë në vazhdimësi duke ku përmbajtur pikave të statutit. Shumë gjërat kanë lëvizur në favor të mësimdhënësve gjë e cila është arritur falë punës, përkushtimit dhe angazhimit të stafit profesional të SBASHK-ut. Sot gjërat janë më të definuara dhe të qarta ku secili mësimdhënës mund të informohet direkt dhe përmes ueb faqes.

Arsimimi sot:

A keni ndonjë këshillë për kolegët tuaj kudo në Kosovë?

Blerina

Të jenë anëtarë të rregullt në anëtarësi duke përfutur nga mundësitë që ofron SBASHK-u qoftë në trajnime dhe fusha tjera. Gjithashtu të jenë të vetëdijshëm për të mirat që ka sjellë angazhimi i SBASHK-ut në mirëqenien dhe të drejtat e mësimdhënies duke i mbrojtur në përballjen e ndryshimeve të mëdha dhe kërkesave të padrejta nga grupet e ndryshme të interesit.

Gjatë muajit

U mbajtën një varg takimesh SBASHK- MASHTI

Në përpjekje për bashkëpunim dhe angazhime të përbashkëta



Pas takimit të parë që përfaqësuesit e SBASHK-ut kishin zhvilluar në ambientet e MASHTI-t, e që kishte për qëllim që fillimisht të përgëzohet Ministra Nagavci për detyrën dhe të shprehet gatishmëria për bashkëpunim në shërbim të arsimit dhe për zgjidhjen e gjithë çështjeve të ngritura, kanë vazhduar takimet e komunikimi i rregullt. Pas kësaj ka ndodhur vizita e Ministres Nagavci me anëtarë të kabinetit të saj në selinë e SBASHK-ut duke shprehur kështu gatishmërinë për bashkëpunim dhe angazhime të përbashkëta në përballje me sfidat e shumta që ka

sjellë pandemia në tërë sektorin e arsimit.

Ministra Nagavci edhe në këtë takim ka shprehur respektin për angazhimet dhe përkushtimin e SBASHK dhe pastaj është bashkëbiseduar lidhur me fillimin e procesit mësimor pas pushimit pranveror, për sfidat aktuale që po përcjellin sistemin e arsimit dhe për angazhimet konkrete e të përbashkëta që duhen bërë me qëllim të rrjedhës së mbarë të procesit mësimor. Koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe zyrtarja Vlora Rexhepi Berisha kanë informuar Ministren Nagavci lidhur me aktivitetet që po zhvillohen nga SBASHK –u për të ndihmuar punëtorët e arsimit në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë.

SBASHK-u vazhdon me angazhimet dhe takimet duke dëshmuar kështu se mbetet i përkushtuar që çështjet të zgjidhen me dialog dhe me angazhime të përbashkëta.

Një aktivitet i veçantë i SBASHK-ut

U përgatiten trajnerë për trajnimin e ri të licencuar

SBASHK ka kohë që falë angazhimet e përkushtimit maksimal të koordinаторit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe stafit qendror ka organizuar trajnime për qindra grupe mësimdhënësish në trajnimet "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social", "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar", "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik" dhe "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" dhe duke respektuar kërkesat e anëtarësisë ka arritur të licencojë në Këshillin Shtetëror të Licencimit edhe një trajnim të ri që është tepër i rëndësishëm për kolegët tanë që punojnë në shkollat fillore. Është fjala për trajnimin "Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimi i tyre në shkollat fillore" dhe stafi qendror ka bërë angazhimet e duhura për përgatitjen e trajnerëve të rinj që të mbajnë me sukses këtë trajnim me kolegët tanë kudo në Kosovë.



Për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti të veçantë janë përkujdesur trajnerët me përvojë prof. dr. Atdhe Hykoll, prof.dr. Hysen Sogojeva dhe koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri. Pjesë e këtij aktiviteti ishin edhe kryetari i SBASHK-ut Rahman jasharaj dhe kryetari i Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve, prof. Osman Beka.

Në hapje të këtij aktiviteti të veçantë kryetari i SBASHK-ut ka falënderuar z. Beka për angazhimin dhe praninë në këtë aktivitet e pastaj ka shprehur respekt për prof. dr. Atdhe Hykoll, prof.dr. Hysen

Sogojeva dhe për koordinatorin për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri të cilët do të angazhohen maksimalisht që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë të të arrij objektivat e caktuara.



Kryetari i Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve, prof. Osman Beka është shprehur i lumtur që është pjesë e këtij aktiviteti të qëlluar duke lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë dhe të ngritjes së cilësisë në arsim. Ai pastaj ka dhënë këshilla me vlerë lidhur me mënyrën e realizimit sa më funksional të këtij aktiviteti.



Koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri u ka treguar trajnerëve të ardhshëm për detyrat konkrete që duhet kryer me kujdes e përkushtim gjatë organizimit dhe mbajtjes së këtij trajnimi me kolegët kudo në Kosovë.

Teksa ishin në vllugun e angazhimeve e debateve lidhur me trajnimin dhe mundësisë që ky aktivitet të jetë sa më atraktiv, pjesëmarrësit janë ndier mirë kur ata i ka vizituar ambasadori i Kosovës në Shqipëri, shkëlqesia e tij, Nait Hasani. Ambasadori Hasani është shprehur se e njeh mirë aktivitetin e SBASHK-ut

dhe se është angazhuar shumë e bashkë me ta edhe lidhur me Ligjin e pagave, i cili ligj, si tha ai, fatkeqësisht nuk gjejnë ende zbatim nga shkakut se Kushtetuesja vendosi ashtu.



Ai po ashtu përgëzoi SBASHK-un për këtë aktivitet

dhe për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë dhe ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim. Ambasadori qëndroi për një kohë me pjesëmarrësit duke përcjellë me kujdes angazhimet e tyre në rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti.



SBASHK u takua me Ministrin Vitia

U përsërit kërkesa që punëtorët e arsimit të jenë prioritet në vaksinim

Jo për të qenë të privilegjuar, por për të krijuar parakushtet që viti arsimor të vazhdojë në institucione arsimore, SBASHK ka ngritur me kohë kërkesën që punëtorët e arsimit të kenë prioritet për t'u vaksinuar. Ky angazhimin i SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit bëri që të hapen debate e të lindin ide, që për shkaqe të ndryshme nuk u realizuan. Me qëllim që kjo çështje të debatohet dhe të merren informacione nga dora e parë SBASHK-u u takua me Ministrin e shëndetësisë Arben Vitia, të cilin, pasi ishte takimi i parë me të, e kanë përgëzuar për t'u

shprehur se do të respektojnë vendimet e institucioneve të shëndetësisë sepse primare për të gjithë është shëndeti i nxënësve dhe punëtorëve të arsimit.

Ata kanë treguar se do të bëjnë gjithë angazhimet që java e mësimi online të jetë sa më e suksesshme duke uruar që situata të krijohet për tu kthyer në institucionet arsimore dhe kanë kërkuar që kjo Ministri ta vë në prioritet vaksinimin e punëtorëve arsimor.



Ministri Vitia ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe është shprehur se do të bëjnë gjithë angazhimet që me ardhjen e kontingjentit të ri të vaksinave punëtorët arsimor të jenë të përfshirë në vaksinim.



SBASHK ka rinisur me organizmin e trajnimeve për anëtarësinë

U rinis me 8 grupe për të vazhduar edhe me dhjetëra grupe të tjera

Duke respektuar kërkesat e shumta të anëtarësisë që kanë ardhur në selinë e SBASHK-ut koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror kanë bërë gjithë përgatitjet dhe në koordinim me kryetarët e nivelit komunal kanë rifilluar me organizimin e trajnimeve. Në vikendin e 17 prillit kanë filluar me trajnimet katër-ditore koleget e kolegët tanë në trajnimet "Udhëheqje dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" me trajnimin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social".




Po ashtu kolegët tanë nga Kosova sot kanë nisur këtë aktivitet në dy grupe të ndara në trajnimin "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për arsimin fillor dhe të mesëm", kurse dy grupe të tjera janë pjesë e trajnimit "Edukim medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik". Derisa këto grupe kanë vazhduar me angazhimet edhe në vikendin e radhës, kanë nisur me këtë aktivitet edhe 20 grupe të reja.



Ky aktivitet voluminoz është nisur me trajnimin "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar". Po këtë ditë kanë nisur me trajnimin edhe grupet e angazhuara në "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm", pastaj "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik" e "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social". SBASHK ka nisur të organizoj edhe trajnimin e licencuar rishtazi "Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimin e tyre në shkollat fillore", që e dedikohet kolegëve tanë që punojnë në arsimin fillore, pra në klasat 1-5, trajnim ky që ka zgjuar interesim të madh të kolegët tanë nga e tërë Kosova dhe prandaj pjesëmarrësit kanë falënderuar SBASHK-un për gjithë angazhimet e suksesshme edhe për këtë trajnim, që do të jetë ndihmesë e madhe për gjithë të punësuarit në arsimin fillor.




Po ashtu në kuadër të këtij aktiviteti është rifilluar edhe me trajnimin shumë të rëndësishme "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie". Ky trajnim do të zhvillohet me prani fizike, pra në ambientet shkollore dhe pas çdo moduli pjesëmarrësit do të dëshmojnë njohuritë e arritura duke u testuar. Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe anëtarë të tjerë nga stafi qendror janë kyçur kohë pas kohe me të gjitha grupet dhe kanë bashkëbiseduar me pjesëmarrësit duke u përgjigjur edhe në pyetjet e tyre konkrete, që kishin të bënin me rrjedhën e trajnimeve, por edhe për çështje sindikale. Ashtu si për angazhimet e aktiviteteve tjera, edhe për këto trajnime zyra për informim ka publikuar shkrime në mënyrë të zgjeruar në ueb faqen e SBASHK-ut.



Vazhdojnë takimet e rregullta të SBASHK-ut me veprimtarët sindikal

Përkushtim për angazhime të reja në shërbim të anëtarësisë

SBASHK vazhdon me komunikimin e vazhdueshëm dhe me takimet e rregullta me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve duke debatuar për detyrat konkrete me qëllim të rrjedhës së mbarë të aktiviteteve sindikale në nivelin komunal dhe atë qendror.



Një atmosferë pune e përkushtimi ishte edhe në takimin e radhës në mbrëmjen e 21 prillit. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka informuar pjesëmarrësit për situatën aktuale në arsim, për angazhimet e stafit qendror dhe për takimet dhe komunikimin me institucionet qendrore. Pas kësaj kryetari Jasharaj ka kujtuar kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve që të bëjnë planifikime konkrete me qëllim që aktivitetet e parapara të realizohen në përpikëri e duke respektuar afatet kohore. Duke folur për aktivitetet konkrete e aktuale Jasharaj është ndalur edhe te trajnimet duke theksuar se vërehet një interesim i madh i anëtarësisë për pjesëmarrje në këtë aktivitet duke përgëzuar koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe stafin qendror për angazhim të jashtëzakonshëm me qëllim të organizimit në nivel të trajnimeve dhe rrjedhës së mbarë të tyre. Kryetarët e nivelit komunal sindikal janë informuar lidhur me këtë aktivitet nga koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, i cili ka treguar se janë duke u bërë gjithë angazhimet me qëllim të realizimit të suksesshëm të trajnimeve për sa më shumë grupe të punëtorëve arsimor dhe se kërkesat janë të shumta për secilin trajnim të licencuar. Ai ka kujtuar pjesëmarrësit se listat e pjesëmarrësve duhet të vijnë në SBASHK vetëm përmes tyre dhe duhet të kenë të gjitha shënimet e duhura të pjesëmarrësve. Koordinatori ka apeluar të kryetarët e nivelit komunal sindikal që të kyçen gjatë trajnimeve për të kontribuar në rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti.

Duke bashkëbiseduar për angazhime të tjera është marrë vendim që kryetarët e nivelit komunal sindikal që tani të takohen me Drejtoritë arsimore dhe t'ua kujtojnë atyre pikat 8 dhe 9 të nenit 11 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të cilat saktësojnë se kryetarët e nivelit komunal sindikal do të punojnë gjysmë norme në arsim e do të marrin pagë të plotë. Kjo bëhet me qëllim të ushtrimit të funksionit sindikal. Po ashtu edhe kryetarët e shoqatave sindikale do të kenë normën javore prej 18 orësh, me qëllim që 2 orë në javë t'i kenë në dispozicion për aktivitete sindikale. Ata do të marrin pagë të plotë.



Në këtë takim është biseduar edhe për pikën 7 të Vendimit të Qeverisë së Kosovës e që ka të bëjë me obligimin e institucioneve që të lirojnë nga obligimi për paraqitje në vendet e punës të punëtorëve shtatzëna si masë mbrojtëse nga Covid-19.

SBASHK-u me kohë ka komunikuar për këtë çështje me Ministren Nagavci dhe pastaj edhe publikisht e përmes medieve ka kërkuar që kjo të zbatohet edhe në sektorin e arsimit. Po ashtu është biseduar edhe për vendimin e MASHTI-t lidhur me organizimin e mësimit plotësues në institucionet arsimore të Kosovës me qëllim që të punohet me nxënësit që nuk kanë mundur të jenë vazhdimisht pjesë e procesit mësimor nga larg. U vendos që të shihet fillimisht se si po organizohet ky aktivitet dhe sa do të jetë ngarkesa shtesë për punëtorët arsimor e pastaj edhe do të vepohet sipas situatës aktuale.

Pjesëmarrësit akne përgëzuar stafin qendror për angazhimet dhe janë pajtuar që të vazhdohet me komunikimin dhe takimet e rregullta e të shpeshta me qëllim të koordinimit të aktiviteteve dhe veprimeve me kohë e në bazë të kërkesave që sjell situata aktuale.

SBASHK iu drejtuar DKA-ve dhe drejtorëve të shkollave

Mësimdhënësit të pajisen me vendime ose të mos mbahet mësimi plotësues

Pandemia ka sjellë vështirësi të mëdha edhe në sistemin arsimor dhe janë bërë angazhime të mëdha të gjithë të punësuarve në arsim për rrjedhë sa më të mbarë të mësimi. Se situata është e rënduar flasin dhe faktet se u desh të zgjatet pushimi dimëror, u desh të shkohohej edhe në pushimin pranveror, edhe pse ishte paraparë që të mbahej procesi mësimor atyre ditëve, u desh që nga 12 e deri më 18 prill Arsimit i mesëm i ulët dhe Arsimit i mesëm i lartë të shkojnë në mësim nga larg. SBASHK-u, DKA-të, drejtorët e shkollave dhe gjithë punëtorët e arsimit me stres po nisin çdo ditë mësimi të lumtur që po arrijnë të realizojnë orarin aktual mësimor.

Gjithë këtë situatë e ka rënduar edhe më shumë Vendimi i MASHTI-t i datës 20.04. 2021 për organizimin e mësimi plotësues për nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e pandemisë Covid 19. Me këtë vendim nuk është pajtuar SBASHK dhe këtë e ka bërë publike duke pritur që të deklarohen edhe DKA-të dhe drejtoritë e shkollave sepse ky vendim nuk është i qëlluar e veçmas tani kur situata është e rënduar nga Covid dhe se nuk është arritur të sigurohet vaksinimi i të punësuarve në arsim dhe se do të jetë sukses e shkuar sukseseve nëse arrijmë të

realizojmë mësimin e rregullt në institucione arsimore pa pasur nevojë të kalohet në mësimin nga larg.

SBASHK në komunikim me disa Drejtori arsimore ka vërejtur se edhe ata nuk janë pajtuar me vendimin plotësues dhe është mirë që ta ngritin këtë çështje duke kërkuar mobilizim për të kryer sa më mirë procesin e rregullt mësimor pa krijuar probleme shtesë me mësimin plotësues. Mirëpo, nëse Vendimi mbetet të ekzekutohet atëherë SBASHK i drejtohet Drejtorive Arsimore që përmes drejtorëve të shkollave të pajisin me vendime individuale secilin mësimdhënës që e angazhojnë në mësimin plotësues duke precizuar sa orë do t'i mbajnë, në cilën kohë e në cilin vend. DKA-të të mos harrojnë se norma javore është 20 orë mësimi dhe se në Kontratën Kolektive të Arsimit saktësohet se çdo orë e mbajtur mbi këtë normë duhet të paguhet si orë e rregullt. SBASHK u drejtohet me apel anëtarësisë, pra punëtorëve në Arsimin Parauniversitar që të mos fillojnë me mësimin plotësues nëse fillimisht nuk u dorëzohen nga drejtoritë vendimet për secilin veç e veç për orët që do të obligohen t'i mbajnë në emër të mësimi plotësues.

SBASHK i drejtohet edhe publikisht ministrit Murati

Kërkesa të qarta që duhet realizuar

Me qëllimin më të mirë që çështjet konkrete të gjejnë zgjidhje përmes komunikimit dhe dialogut, SBASHK i ka dërguar dy kërkesa Ministrit Hekuran Murati dhe pasi ai nuk është përgjigjur, kërkesa i është bërë në mënyrë publike e përmes medieve. Në këtë mënyrë SBASHK ka treguar se Ministri Murati dhe ministria që drejton duhet të angazhohet që të realizojë shtesat në pagë sipas vendimit të Qeverisë nr. 08/65 i datës 18.02.2021 – pika 8 e këtij vendimi, i cili obligon Ministrinë e Financave, Punës e Transfereve (MFPT) për t'i ekzekutuar këto shtesa, duke i kujtuar se nuk janë realizuar për muajin mars. Ministrit e as për muajt tjerë pasues për çka SBASHK ka sjellë edhe

argumente përmes shkresës zyrtare drejtuar Ministrit Murati.

SBASHK-u publikisht i ka kujtuar Ministrit Murati po ashtu se muaji prill është muaji kur bëhet ngritja e përvojës së punës për një vit duke shpresuar që ne pagat e muajit prill kjo ngritje do të pasqyrohet në listat e pagave.



Në letrën publike, por edhe në takimin që duhet të ndodh, përfaqësuesit e SBASHK kujtojnë z.Murati se ai është edhe ministër i punës dhe sipas Ligjit të Këshillit Ekonomik Social

(KES) jeni edhe pjesë e këtij Këshilli, që nxit dhe zhvillohen dialogun me sindikatat. Bazuar në këtë fakt Ministri Murati duhet të gjej kohë të takohet me përfaqësuesit e SBASHK-ut për të zhvilluar dialog konkret e të frytshëm me qëllim të realizimit të gjithë obligimeve financiare që ka Qeveria ndaj punëtorëve të arsimit, e në veçanti si çështje urgjente është edhe çështja e mësimdhënësve me sëmundje të rënda, të cilët janë liruar nga puna me pagesë të plotë sipas master-planit të MASHTI-t e aprovuar nga Qeveria me nr. 01/27 i datës 26.08.2021. Ky vendim është realizuar me vështirësi dhe jo në formën e duhur e si

është paraparë me Vendim dhe aty e këtu kanë nisur të paraqiten raste kur ndonjë DKA ka urdhëruar punëtorët me sëmundje të rënda të paraqiten në vende pune edhe pse gjendja e tyre shëndetësore ka mbetur e rënduar. SBASHK-u për këtë ka alarmuar edhe Ministren Nagavci duke kujtuar se në kohën kur Qeveria e Kosovës po angazhohet të mbroj punëtorët shtatzëna duke i liruar nga obligimi për paraqitje në vende pune, është veprim jo human të kërkohej që punëtorët e sëmurë rënd të kthehen në punë sepse prekja me Covid për ta do të kishte pasoja fatale dhe për këtë dikush duhet të jetë përgjegjës.

Reagim i SBASHK-ut ndaj disa deklarimeve të Ministres Nagavci **Ministre ruaju nga deklaratimet që lexohen si kërcënim**

Është e natyrshme që MASHTI të përgjigjet e të reagojë ndaj deklarimeve të SBASHK-ut për çështjet e ngritura e të bëra publike, por përgjigja duhet të jetë e mbështetur në argumente të qëndrueshme e në fakte e jo në fjali të veshura me mllef e akuza që nuk qëndrojnë.

E nderuar Ministre as një fakt nuk e ke ofruar në kuadër të akuzës se edhe SBASHK qenka përgjegjës për “rezultatet e ulëta” në arsim. SBASHK nuk ka qenë kreator i reformave, as i kurrikulit, as përpilues e botues i teksteve shumë të kritikuara shkollë e as nuk shpall konkurse e as nuk pranon kuadro në arsim. SBASHK-u as nuk solli vendim që të lirohen nga puna punëtorët shtatzëna e as që ato të zëvendësohen me studentë, kur në Kosovë ka mjaft kuadro të diplomuara që janë duke pritur me vite për të punuar bile ca ditë a javë në arsim.



E nderuara Ministre anëtarësia e SBASHK-ut edhe në vitet e okupimit bëri sakrifica sublimë duke mbrojtur arsimin shqip edhe tani në kohë pandemie po bën angazhime të vazhdueshme për të

mbajtur sa më gjatë e sa më mirë procesin mësimor edhe për kundër numrit të madh të të prekurve me Covid. Ne madje u angazhuam dhe arritëm të gjejmë mundësi bashkë me institucionet që të lirohen nga

procesi mësimor punëtorët arsimor me sëmundje të rënda, por të tjerët as edhe këtë marrëveshje nuk e realizuan ashtu si duhet. Ne vazhdojmë të japim kontribut konkretet në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë duke inkurajuar e mobilizuar anëtarësinë e duke mbajtur pa u ndalur trajnime pa pasur mbështetjen e askujt dhe duhet parë të tjerët a po kanë angazhime konkrete në këtë përpjekje.

E nderuar Ministre është e natyrshme që të dallojmë në qasje e deklarime për të njëjtat çështje, por po ju këshillojmë miqësisht të ruheni nga deklaratimet që lexohen si kërcënim. Një i tillë, e që keni nisur të përsëritni sa herë po reagoni ndaj deklarimeve e angazhimeve tona është edhe :

“Në këtë kohë kur shumë njerëz i kanë humbur vendet e punës për shkak të pandemisë jo vetëm në Kosovë por gjithandej në botë, mësimdhënësit duhet ta ndjejnë veten me fat që janë në marrëdhënie pune”.

Ne vërtetë jemi krenar e të lumtur që jemi mësimdhënës dhe jemi në punë dhe angazhohemi aq sa mundemi e dimë të arsimojmë e edukojmë brezat, por këto vende pune nuk na i fali dikush për mëshirë e sadaka. Ju duke e përsëritur shpesh këtë deklaratë tuajën sikur po dërgoni mesazh si disa pronarë të firmave private që u thonë të punësuarve, kurdo që ata

ankohen arsyeshëm, se duhet të heshtin e të ndihen mirë që janë në punë, se njerëz të papunë ka mjaft.

Ministre, SBASHK-u alarmon, kritikon, angazhohet për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë, por nuk shantazhon e as nuk kërcënon, por as nuk u është

dorëzuar e nuk u dorëzohet kurrë shantazheve e as përpjekjeve të dikujt që ka tentuar ta lëndoj unitetin e shkëlqyer të sindikatës sonë. Ne do të vazhdojmë të jemi zëri i anëtarësisë sonë dhe presim bashkëpunim korrekt me MASHTI-n.

Aktivitetet e shumta të ETUCE me sindikatat anëtare **Shkëmbim idesh për çështje aktuale në arsim**

Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) vazhdon me organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me sindikatat anëtare duke krijuar mundësi të komunikimit dhe të shkëmbimit të ideve lidhur me angazhimet në situatën aktuale e në kushtet e vështirësuar të punës nga pandemia. Kohëve të fundit janë zhvilluar disa aktivitete të kësaj natyre, prej të cilave do veçuar takimet nga larg "Sindikatat e Arsimit dhe Shkollat Përfshirëse, adresimi i nevojave për trajnim të personelit arsimor për arsimin gjithëpërfshirës". Këto angazhime të ETUCE kanë vazhduar edhe me uebinarin e parë "Një qasje e tërë shkollës për arsimin gjithëpërfshirës", të cilin SBASHK-un e përfaqësoi Shqipe Dubovci, pastaj u organizua uebinari i 12 prillit "Mësim dhe punë e sigurt dhe e shëndetshme", të cilin sindikatën tonë e kanë përfaqësuar kryetari Rrahman Jasharaj dhe zyrtarja Vlora Rexhepi Berisha dhe ai i 29 prillit "Përdorimi i teknologjive dhe mediave dixhitale për të nxitur përfshirjen", në të cilin kanë marrë pjesë nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.

prezantimet e udhëheqësve të ETUCE-s dhe të panelistëve, por edhe kanë dhënë kontribut duke dhënë shembuj konkret nga angazhimet që bën SBASHK në kuadër të këtyre angazhimeve e në kushte mjaft të vështirësuar nga Covid 19.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut në gjithë këto takime nga larg kanë përcjell me vëmendje debatet dhe

Përfaqësuesit e SBASHK-ut pas pjesëmarrjes aktive në këto aktivitete ndërkombëtare të organizuara nga ETUCE, por edhe Internacionalja e Arsimit (EI) përgatisin edhe shkrime e raporte për t'i pasur si bazë të mirë të angazhimeve në aktivitetet e brendshme sindikale.

Në këtë numër të gazetës sonë "Arsimimi sot" po sjellim shkrimin e përgatitur nga kolegja jonë Shqipe Dubovci lidhur me aktivitetin tjetër sindikal që ka marrë pjesë ajo.



Kontribut i koleges sonë Shqipe Dubovci për gazetën tonë

Raport nga konferenca dy ditore e Komitetit të Sindikatave Evropiane të Arsimit

Me ftesë të Komitetit të Sindikatave Evropiane të Arsimit, si anëtare e Këshillit Drejtues të SBASHK, mori pjesë në konferencën dy ditore me temën: Sindikatat e arsimit në adresimin e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisorë. Për shkak të rrethanave të Pandemisë Covid-19, konferenca u mbajt virtualisht përmes platformës ZOOM me datat 22-23 Prill 2021. Në takim morën pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të arsimit, anëtarë të Komitetit të Sindikatave Evropiane, nga vende evropiane dhe vende të Ballkanit Perëndimor. Me fjalimet mirëseardhëse konferencën e hapen z. Larry Flanagan, president i Sindikatave Evropiane të Arsimit (ETUCE) dhe znj. Susan Flocken, drejtore Evropiane, të cilët reflektuan mbi rolin e sindikatave të arsimit në adresimin e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisorë. Më pas, znj. Ekaterina Efimenko nga ETUCE e prezantoi projektin para një audience të gjerë të përfaqësuesve të sindikatave të arsimit, ku më pas u zhvillua edhe diskutim përmes pyetje-përgjigjeve lidhur me projektin e prezantuar. Në vazhdim paneli i ekspertëve i përbërë nga znj. Ulrike Pisiotis nga Departamenti i Përgjithshëm për Arsim dhe Kulturë (DG EAC) i Komisionit Evropian dhe Znj. Tatjana Babrauskienė nga Komiteti Ekonomik dhe Social (EESC), përmes një diskutimi interaktiv trajtuan temën, “Pse arsimimi është i rëndësishëm për adresimin e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor”. Pas kësaj pjese u zhvillua seanca plenare ku vende të ndryshme pasqyruan përvojat e tyre me qasje të ndryshme në adresimin e çështjeve mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm në

sistemin arsimor. Në vazhdim e punimeve të konferencës, përvojat pozitive nacionale në adresimin e një mjedisi të qëndrueshëm arsimor i sollën Norvegjia, nga projekti Eco Schools, si dhe grupi punues për hulumtimin e klimës arsimore nga Universiteti Antwerp. Pas një diskutimi lidhur me përvojat pozitive të prezantuara, dhe pas shumë pyetje dhe përgjigj përfundoi edhe dita e parë e konferencës.



Dita e dytë e konferencës filloi me reflektim të grupeve punuese nga punimet e ditës së parë, për të vazhduar më pas me prezantimin e Z. Jennifer Ulric me temën "Mëso për Planetin" një thirrje globale për veprime klimatike dhe arsimim për zhvillim të qëndrueshëm, që u pasua me debat përmes pyetjeve dhe përgjigjeve. Roli i sindikatave të arsimit në adresimin e zhvillimit të një mjedisi të qëndrueshëm zuri një hapësirë të theksuar në punimet e konferencës, temë të cilën e prezantuan Z. Felix Mailleux nga Sindikatat Evropiane (ETUC), Z. Jacob Sfejstrup, nga Kompania Daneze Globale e Farave DLF, Znj. Marianne Quick, nga Sindikata e Kolegeve dhe Universiteteve të Mbretërisë së Bashkuar (UCU UK), si dhe Znj. Claudio Franchi nga Federata Italiane e Punëtorëve të Dijes (FLC-CGIL). Më pas, konferenca i zhvilloi punimet në seancën plenare ku u adresuan sfidat me të cilat janë duke u përballur sindikatat e arsimit, si dhe ambienti i tyre në vendimet politike në adresimin e një ambienti të qëndrueshëm. Në fund të kësaj seance plenare hulumtuesit e projektit shpjeguan edhe për hulumtimet e ardhshme online në adresimin e ambientit të qëndrueshëm në arsim midis anëtarëve të Sindikatave Evropiane të Arsimit (ETUCE).

Më pas konferenca i zhvilloi punimet në grupe, ku u diskutuan nevojat e mësuesve, akademikëve dhe

personelit tjetër edukativ lidhur me kontributin e arsimit për zhvillim të qëndrueshëm, si dhe rolin e sindikatave të arsimit në adresimin e këtyre nevojave. Pas përfundimit të punës në grupe, në një seancë të përbashkët, grupet raportuan në sesionin plenar.

Duke i përmbledhur aktivitetet dy ditore, konferencën e mbylli drejtoresha Evropiane znj. Susan Flocken.



Përmbledhje

Nga puna dy ditore e konferencës Evropiane për Arsim me një pjesëmarrje të gjerë të sindikatave

anëtare, u shtjelluan tema të rëndësishme të cilat rrisin rolin dhe përgjegjësin e sindikatave në zhvillimin e një ambienti të qëndrueshëm arsimor. Përvojat pozitive që i sollën përfaqësues të vendeve të zhvilluara në këtë konferencë, ishin më së të dobishme edhe për sindikatat tjera dhe SBASHK-un, e qëllim të anësimit të rolit të sindikatave në zhvillimin e një ambienti të qëndrueshëm arsimor. Edhe pse në rrethana pandemie, të përcjellore me vështirësi teknike për shkak të mbajtjes nga distanca, konferenca Evropiane për Arsim arriti ta përcjell mesazhin tek të gjitha sindikatat anëtare që ishin pjesëmarrës në këtë konferencë.

Rekomandime

Me qëllim të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave të mira me SBASHK duhet të marr pjesë në të gjitha takimet dhe konferencat e këtij niveli;

Në takime me kryetar të sindikatave komunale të arsimit, si një nga pikat e rendit të ditës të jetë edhe një informata lidhur me këto takime.

